



Акционерско друштво во државна сопственост за вршење на дејноста
давање услуги во воздухопловната навигација

Shoqëri aksionare në pronësi shtetërore për kryerjen e veprimtarisë
ofrim të shërbimeve në fluturimin ajror

SHA "M-NAV"

Programi i investimeve për vitin 2021

Nëntor, 2020

"Босфор" Бр.7, Мралино, Илинден
Република Северна Македонија
Тел: +389 2 3148100 Факс: +389 2 3148239
E-mail: info@mnavigation.mk



"Bosfor" Nr.7, Mralino, Ilinden
Republika e Maqedonisë së Veriut
Tel: +389 2 3148100 Fax: +389 2 3148239
E-mail: info@mnavigation.mk

IDENTIFIKIMI I DOKUMENTIT

Përshkrimi i dokumentit: Programi i investimeve i SHA “M-NAV” Shkup, për vitin 2021 përfshin vlerën e përgjithshme të investimeve të planifikuara për vitin 2021, sqarimin për financimin e investimeve të planifikuara, si dhe shfaqjen e veçantë të investimeve të financuara me mjete të siguruara me hua nga BERZH-i dhe investimet e planifikuara me mjetet personale dhe/ose me mbështetje nga investimet vendore dhe ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, është dhënë një paraqitje tabelore e strukturës financiare të investimeve.

Titull

SHA “M-NAV” PROGRAMI I INVESTIMEVE PËR VITIN 2021

Numri i referimit: MNV-810-103.09

Numri i botimit: 1.0

Data: 27/11/2020

Ekstrakti:

“...Në të njëjtën kohë, investimet e planifikuara në vlerën e tyre të përgjithshme përfaqësojnë një dalje të fondeve vetjake të shoqërisë për vitin 2021. Shpenzimet nga investimet në vitin 2021 do të shprehen nëpërmjet kostove të amortizimit në Planin financiar të “M-NAV” për vitin 2022, 2023, 2024 ... etj., varësisht nga periudha e amortizimit të investimeve”

Fjalët kyçe:

Kontrata e huasë e lidhur me BERZH-in, investimet e planifikuara, fondet vetjake, fondet e siguruara me hua nga BERZH-i, financimi i investimeve, amortizimi, struktura financiare e investimeve.

Statusi i dokumentit:

Versioni i punës

Versioni përfundimtar

Botim i publikuar

Klasifikimi:

Dokument i brendshëm

Dokument publik

i besueshëm

Lokacioni: Shkup

PRANIMI I DOKUMENTIT

Në tabelën në vijim janë renditur autorët dhe personat të cilët kanë përgatitur/miratuar këtë dokument.

Funksioni	Emri, mbiemri dhe nënshkrimi	Data
Përpunoi	Filip Trandafilovski Këshilltar i pavarur në Njësinë e planifikimit, zhvillimit dhe huamarrjes ndërkombëtare	
Kontrolloi aspektin - cilësinë	Leonora Shala Shefe e Seksionit të cilësisë dhe sigurisë në Njësinë e sigurisë, sigurimit dhe cilësisë	
Me pëlqim të	Olivera Micevska Udhëheqës i Njësisë së planifikimit, zhvillimit dhe huamarrjes ndërkombëtare	
Miratuar nga	Fahrudin Hamidi Kryetar i Bordit drejtues dhe Drejtor ekzekutiv i Navigacionit ajror Vlladko Krstevski Anëtar i Bordit drejtues dhe Drejtor ekzekutiv i Teknikës ajrore Migjen Salmani Anëtar i Bordit drejtues dhe Drejtor ekzekutiv i Çështjeve financiare, juridike, i zhvillimit dhe i investimeve	

PËRMBAJTJE

1.	PROGRAMI I INVESTIMEVE I SHA "M-NAV"	5
2.	FINANCIMI I INVESTIMEVE TË PLANIFIKUARA PËR VITIN 2021	5
3.	INVESTIMET E FINANCUARA NGA FONDET E BERZH-it	6
4.	INVESTIMET E PLANIFIKUARA NGA FONDET PERSONALE DHE/OSE ME MBËSHTETJEN E INSTITUCIONEVE VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE.....	9
5.	STRUKTURA FINANCIARE E INVESTIMEVE.....	11

1. PROGRAMI INVESTUES I SHA "M-NAV"

PERIUDHA: VITI 2021

VLERA E PËRGJITHSHME: 341.796.708,00 DENARË

2. FINANCIMI I INVESTIMEVE TË PLANIFIKUARA PËR VITIN 2021

Në bazë të nenit 60 të Ligjit të Aviacionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 14/06, 24/07, 103/08, 67/10, 24/12, 80/12, 155/12, 42/14, 97/15, 152/15, 27/16, 31/16 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 220/19), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut themelon Shoqërinë Aksionare në pronësi të shtetit për kryerjen e veprimtarisë, ofrim të shërbimeve në fluturimin ajror - SHA "M-NAV" dhe i njëjti është regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 4.6.2009

Si shoqëri tregtare, në përputhje me nenin 469 të Ligjit të Shoqërive Tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 28/2004, 85/2005, 25/2007, 87/2008, 42/10, 48 / 10, 24/11, 166/12, 70/13, 119/13, 120/13, 187/13, 38/14, 41/14, 138/14, 88/15, 192/15, 6/16, 30/16, 61/16, 64/18 dhe 120/18), SHA "M-NAV" është e detyruar të përgatisë dhe të paraqesë raporte në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, të botuara në "Gazetën Zyrtare të RM-së" nr. 159/2009, sipas të cilave, shoqata i përgatit pasqyrat e saj financiare, bazuar në principet dhe parimet e kontabilitetit.

Kjo do të thotë që SHA "M-NAV" me regjistrimin e saj në vitin 2009, si një shoqëri aksionare që ka burimet e veta të të ardhurave, nuk planifikon fondet e investimeve në shumën e përgjithshme si një normë e shpenzimeve në Planin financiar të shoqërisë, por në përputhje me dispozitat e Ligjit të Shoqërive Tregtare dhe standardet ndërkombëtare të miratuara për raportim financiar - **shpenzimi i investimeve shprehet nëpërmjet amortizimit, d.m.th. vetëm pjesa e bazuar në amortizimin e llogaritur njihet si një normë shpenzimi në Planin financiar.**

Në të njëjtën kohë, investimet e planifikuara në shumën e tyre të përgjithshme përfaqësojnë një dalje të fondeve vetjake të shoqërisë për vitin 2021. Shpenzimi i investimeve për vitin 2021 do të shprehet nëpërmjet shpenzimit të amortizimit në Planin financiar të "M-NAV"-it për vitin 2022, 2023, 2024 ... etj. varësisht nga periudha e amortizimit të investimit.

Në pajtim me të lartpërmendurën, SHA "M-NAV" me fondet e disponueshme të siguruara me hua nga BERZH-i, si dhe nga fondet personale dhe/ose me mbështetjen nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare, duke marrë parasysh pajtueshmërinë e plotë të flukseve të mjeteve dhe likuiditetit të sipërmarrjes, në vitin 2021 planifikon të realizojë investime totale në vlerë prej 341.796.708.00 denarë.

Qëllimi i investimeve të planifikuara dhe burimet e financimit janë renditur në pikën 3 dhe pikën 4 më poshtë.

3. INVESTIMET E FINANCUARA NGA FONDET E BERZH-it

VLERA E PËRGJITHSHME: 279.496.708,00 DENARË

Në përputhje me kontratën e huasë të lidhur me BERZH-in, Opera. (Operacioni) nr. 44067, datë 24. 9.2013 për financimin e "Projektit për avancimin e sistemit të navigacionit ajror të Maqedonisë - faza e dytë" në vlerë totale prej 11,150,000.00 euro, SHA "M-NAV" për vitin 2021 planifikon realizimin e investimeve si vijon.

	Emri i projektit/aktivitetit	Përshkrim i shkurtër dhe statusi i realizimit	Buxheti i parashikuar për vitin 2021
1.	Furnizimi i një sistemi të ri ATM, duke përfshirë një sallë teknike operative	<p>Sistemi ATM është sistemi primar nëpërmjet të cilit realizohet shërbimi bazë i SHA "M-NAV", d.m.th. sigurimin e shërbimeve të navigacionit të fluturimit ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me qëllim të kryerjes së trafikut ajror të sigurt, të rregullt dhe efikas. Pas procedurës së zbatuar plotësisht të prokurimit në dy faza, dhe miratimin e marrë nga BERZH-i më 31.7.2017, më 14.12.2018, ishte lidhur një kontratë furnizimi me firmën "Leonardo", me vlerë totale 484,550,659.00 denarë, e cila hyri në fuqi më 2.4.2019, me një periudhë zbatimi prej 22 muajsh. Më 12 mars 2020 "M-NAV" e pranoi njoftimin nga firma "Leonardo" për aktivizimin e klauzolës së fuqisë madhore, për shkak të pandemisë Kovid-19 dhe u ra dakord që të vazhdohen aktivitetet brenda situatës së lejuar, por që do të ketë një zhvendosje kohore në fazat e zbatimit për periudhën e kohëzgjatjes së fuqisë madhore, pas përfundimit të së cilës do të vazhdojë zbatimi në faza, dhe gjithashtu pagesa në faza, sipas kontratës.</p>	196.074.977,00
2.	Radio sistemi VHF dhe lidhja me mikrovalë	<p>Sistemi VHF është Sistem radio lidhje me aeroplanët, i cili operon nëpërmjet sistemit të radio komunikimit në qarkun e frekuencës së destinuar ekskluzivisht për atë qëllim. Ky projekt duhet të zëvendësojë pajisjet ekzistuese të radios dhe sistemin e transmetimit me një të ri.</p> <p>Pas zbatimit të procedurës së plotë të prokurimit dhe miratimit të marrë (207.2018) nga BERZH-i për nënshkrimin e Kontratës, ishin hedhur poshtë ankesat për përzgjedhjen e ofertuesit më të mirë të ranguar të dorëzuar nga dy kompani deri te BERZH-i, Kontrata dhe Amendamenti nr. 1 i Kontratës me nënshkrimin e Park Air Systems, datë 11.3.2019 në shumë të përgjithshme prej 47.850.355,00 denarë, përderisa e njëjta hyn në fuqi më 12.7.2019. Më 23.3.2020 Park Air Systems u thirr në klauzolën Forcë madhore për shkak të Kovid-19 që rezultoi me vonesën e realizimit të kontratës. Pritet që aktivitetet të vazhdojnë pas mbarimit të rrethanave të jashtëzakonshme dhe</p>	29.932.352,00

		kontrata të finalizohet deri në vitin 2021.	
3.	Sistemi i komunikimit me zë (Voice Communication System) (VCS)	<p>Sistemi VCS është një nga sistemet themelore nëpërmjet të cilit kontrolluesi i trafikut ajror komunikon me aeroplanët, por edhe me qendrat fqinje të kontrollit të trafikut ajror. Sistemi i ri do të bëhet sistemi kryesor, nëpërmjet të cilit do të realizohet komunikimi në kontrollin e trafikut ajror, ndërsa ai ekzistues do të vepronte si një sistem rezervë. Procedura e furnizimit me një sistem të ri VCS, është kryer në vitin 2017 dhe 2018, por për shkak të mosrespektimit të kërkesave teknike nga të gjithë ofertuesit, miratimi është marrë më 19 qershor 2018 nga BERZH-i, për furnizimin e përsëritur me specifikimet teknike të rishikuara. Përgatitja e dokumentacionit të ri të tenderit në koordinim me këshilltarët pritet të përfundojë në fund të vitit 2020, si dhe miratimi nga BERZH-i dhe shpallja e thirrjes së furnizimit të bëhet në dy faza. Planifikohet që në vitin 2021 të përfundohen dy fazat e furnizimit, të përfundohet një kontratë me ofertuesin më të volitshëm dhe të bëhet pagesa e fazës së parë sipas kontratës, si dhe të përfundojë zbatimimi i projektit deri në fund të vitit 2022.</p>	7.995.000,00
4.	Furnizimi, instalimi dhe lëshimi i një radari të ri mbikëqyrës, sekondar Mode-S (Mode-S Enhanced Surveillance Ground Station Implementation)	<p>Ky sistem do të zëvendësojë sistemin ekzistues të radarëve Thomson, dhe në të njëjtën kohë do ta rrisë ndjeshëm besueshmërinë e të dhënave të radarëve që do të ndikojnë drejtpërdrejt në kapacitetin dhe sigurinë e trafikut ajror, që zhvillohet në hapësirat e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Raporti i rishikuar i vlerësimit që kërkon përsëritjen e tenderit të procedurës së furnizimit, u miratua nga BERZH-i më 9.5.2018.</p> <p>Përgatitja e dokumentacionit të ri të tenderit në koordinim me këshilltarët pritet të përfundojë në fund të vitit 2020, si dhe miratimi nga BERZH-i dhe shpallja e thirrjes së furnizimit të bëhet në dy faza. Planifikohet që në vitin 2021 të përfundohen dy fazat e furnizimit, të përfundohet kontrata me ofertuesin më të volitshëm dhe të bëhet pagesa e fazës së parë sipas kontratës, si dhe të përfundojë zbatimimi i projektit deri në fund të vitit 2022.</p>	26.445.000,00
5.	Furnizimi i pajisjeve meteorologjike për aeroportet e Shkupit dhe të Ohrit (Sistemet AWOS/ATIS/VOLMET)	<p>Zëvendësimi i sistemeve ekzistuese AWOS / ATIS / VOLMET, që ka të bëjë me zëvendësimin e dy stacioneve Artais AWOS 2000, në aeroportet e Shkupit dhe të Ohrit, si dhe zëvendësimin e sistemeve ATIS dhe VOLMET të vendosura në aeroportin e Shkupit, të cilat do të arrijnë sigurim të vazhdueshëm dhe pa ndërprerje të kujdesit meteorologjik të trafikut ajror dhe shpërndarjen në kohë të informacionit MET të aviacionit. Është lidhur kontratë me kompaninë "Telvent Netherland" më 11.12.2015 me vlerë totale prej 46,181,580.00 denarë. Trajnimet e planifikuara dhe testimi në fabrikë (FAT) janë realizuar. Instalimi i sistemit ka përfunduar, është realizuar testimi i</p>	12.284.379,00

		sistemeve për pranimin e tyre pas instalimit (SAT) në Shkup dhe Ohër, për të cilin është lëshuar certifikatë përkatëse. Testimi për pranimin operativ të sistemeve (OAC) është duke u zhvilluar, si dhe negociatat për kompensimin e gjobave për shkak të vonesave në realizimin nga firma "Telvent Netherland". Situata e shkaktuar nga pandemia Kovid-19 solli disa vonesa, por zbatimi i plotë i kontratës pritet të përfundojë deri në fund të vitit 2020 dhe pagesa përfundimtare, sipas kontratës, të bëhet në tremujorin e parë të vitit 2021.	
6.	Shërbimet Këshilluese - Ndiurma për Zbatimin e Projektit	Pas zbatimit të procedurës për furnizimin e shërbimeve këshilluese për ndihmë, në zbatimin e projekteve të financuara me hua nga BERZH-i, i sigurohet njësisë "M-NAV", përgjegjëse për zbatimin e "Projektit për avancimin e sistemit të navigacionit ajror të Maqedonisë - faza e dytë" (Njësia e zbatimit të projektit) dhe pas marrjes së miratimit nga BERZH-i, më 5.7.2018 u lidh një marrëveshje me firmën "Egof Avia" nga Franca, me një çmim kontrate prej 12,277,553.00 denarë dhe një periudhë zbatimi prej dy vjetësh. Më 9.7.2020, u lidh amendamenti nr. 1 i kontratës, i cili zgjat vlefshmërinë e marrëveshjes për 18 muaj shtesë, d.m.th. deri në fillim të vitit 2022.	6.765.000,00

4. INVESTIMET E PLANIFIKUARA NGA FONDET PERSONALE DHE/OSE ME MBËSHTETJEN E INSTITUCIONEVE VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE

VLERA E PËRGJITHSHME: 62.300.000,00 DENARË

	Emri i projektit/aktivitetit	Përshkrimi i shkurtër dhe statusi i realizimit	Buxheti i parashikuar për vitin 2021
	Komponentë të synuar për sistemin e ri ATM	Furnizimi i monitorëve (monitorët ATC 2Kx2K), 4 (katër) printerë termikë (Toshiba B SA4T G) dhe 15 (pesëmbëdhjetë) terminale IDS (kompjuterë me një model të përcaktuar saktësisht, sipas specifikimeve të marra nga integruesi i sistemit të ri ATM - Leonardo) si pjesë e sistemit të ri ATM, i cili do të zëvendësojë pajisjet ekzistuese.	10.000.000,00
2.	Furnizimi i dy burimeve të pavarura të energjisë së tepërt elektrike	Furnizimi i 2 burimeve të tepërta të energjisë elektrike do të sigurojë nevojat e ndërtesës ekzistuese dhe ndërtesës së re të ATM-së.	6.000.000,00
3.	Përshtatja e sallës teknike (përshtatja e hapësirës së garazhit)	Përshtatja e hapësirave të përkohshme për qëllime teknike është e nevojshme në mënyrë që sistemet e reja VCS, VHF dhe VRRS të instalohen dhe të vihen në përdorim të ndërlidhur me sistemin aktual ATM, pavarësisht nga procesi i instalimit të sistemit të ri ATM, i cili përfshin edhe sallën tekniko-operative. Kjo do të mundësojë zëvendësimin e sistemeve ekzistuese sa më shpejt të jetë e mundur, përkatësisht do të rrisë sigurinë e të gjithë sistemit ATM.	18.500.000,00
4.	Furnizimi i sistemit WAM, përfshirë dhe funksionalitetin ADS-B	Me furnizimin dhe instalimin e sistemit WAM do të përmbushen kërkesat, si dhe specifikimet teknike të përshkruara në standardin EUROCAE ED-142. Në periudhën e ardhshme, do të ketë ndërlidhje me sistemin e ri ATM, i cili do të sigurojë saktësi më të madhe, mirëmbajtje të thjeshtuar dhe përfitim më të madh financiar. Nga vlera e përgjithshme e planifikuar e sistemit WAM (74,000,000.00 denarë), 20% e vlerës do të realizohet në vitin 2021, ndërsa pjesa tjetër (59,200,000.00 denarë) do të realizohet në vitin 2022.	14.800.000,00 (20% nga vlera e përgjithshme e planifikuar)

5.	Furnizimi i sistemit të ri ILS dhe pajisjes së re DME, instalimi dhe lëshimi në punë – “Shën Apostol Pali” Ohër dhe furnizimi dhe instalimi i një DME-je të re, si pjesë e sistemit ILS në Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit	<p>Për të ruajtur nivelin e lartë të cilësisë, disponueshmërisë dhe vazhdimësisë së shërbimeve të “M-NAV”, është e nevojshme të zëvendësohen me shërbime të reja që do të mundësojnë ruajtjen e nivelit të shërbimeve. Zëvendësimi duhet të bëhet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sistemin ILS të destinuar për aeroportin “Shën Apostol Pali”, Ohër. • Pajisjen DME të destinuar për aeroportin “Shën Apostol Pali”, Ohër. • Pajisjen DME të destinuar për Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit. • Pajisjen DVOR për aeroportin “Shën Apostol Pali” në Ohër. <p>Nga vlera e përgjithshme e planifikuar e sistemit ILS (65,000,000.00 denarë), 20% do të realizohet në vitin 2021, ndërsa pjesa tjetër (52,000,000.00 denarë) do të realizohet në vitin 2022.</p>	<p>13.000.000,00 (20% nga vlera e përgjithshme e planifikuar)</p>
----	--	--	---

5. STRUKTURA FINANCIARE E INVESTIMEVE

	TË ARDHURAT E SPECIFIKUARA	TË REALIZUARA për vitin 2020¹	TË PLANIFIKUARA për vitin 2021	TË REALIZUARA për vitin 2021	Analiza krahasuese e realizuar v.2021/realizuar v.2020 (%)	Analiza krahasuese e realizuar v.2021/planifikuar v.2021 (%)	Analiza strukture për vitin 2021 (%)
	Të ardhurat nga veprimtaria						
1	Fluturimet	507.596.294,80	644.934.823,10	0	0	0	0
2	Shërbimet terminale	81.911.544,35	81.948.183,46	0	0	0	0
3	Gjithsej të ardhurat operative (1 + 2)	589.507.839,15	726.883.006,56	0	0	0	0
	Të ardhura të tjera						
4	Shërbime të tjera	10.149.299,72	12.000.000,00	0	0	0	0
5	Gjithsej të ardhurat e tjera (4)	10.149.299,72	12.000.000,00	0	0	0	0
6	Të ardhurat përgjithshme (3 +5)	599.657.138,87	738.883.006,56	0	0	0	0

¹ Gjatë raportimit të të ardhurave të realizuara për vitin 2020, për arsyen kur përgatitej Plani financiar për vitin 2020, ato nuk ishin ende plotësisht të disponueshme, të dhënat aktuale u morën më 30.9.2020. Për tremujorin e katërt të vitit 2020, merren të ardhurat e planifikuara nga Plani financiar i shoqërisë, për vitin 2020.

TË ARDHURA TË SPECIFIKUARA	TË REALIZUARA për vitin 2020 ²	TË PLANIFIKUARA për vitin 2021	TË REALIZUARA për vitin 2021	Analiza krahasuese e realizuar v.2021/realizuar v.2020 (%)	Analiza krahasuese e realizuar v.2021/planifikuar v.2021 (%)	Analiza Strukturore për vitin 2021 (%)
Të ardhurat nga veprimtaria						
1	Shpenzimet për të punësuarit	715.627.370,00	559.862.000,00	0	0	0
2	Shpenzimet materiale	52.722.437,14	71.200.000,00	0	0	0
3	Shpenzimet jomateriale	62.979.972,35	67.125.000,00	0	0	0
4	Amortizimi	60.000.000,00	58.500.000,00	0	0	0
5	Gjithsej shpenzimet operative (1 + 2 + 3 + 4)	891.329.779,49	756.687.000,00	0	0	0
Shpenzime të tjera						
6	Shpenzimet e tjera nga puna	1.963.814,60	6.000.000,00	0	0	0
7	Shpenzimet financiare	15.151.511,06	15.000.000,00	0	0	0
8	Gjithsej shpenzimet e tjera (6 + 7)	17.115.325,66	21.000.000,00	0	0	0
9	Shpenzimet e përgjithshme (5 + 8)	908.445.105,15	777.687.000,00	0	0	0

² Gjatë raportimit të të ardhurave të realizuara për vitin 2020, për arsyen kur përgatitej Plani financiar për vitin 2020, ato nuk ishin ende plotësisht të disponueshme, të dhënat aktuale u morën më 30.9.2020. Për tremujorin e katërt të vitit 2020, merren të ardhurat e planifikuara nga Plani financiar i shoqërisë, për vitin 2020.

PASQYRA E KREDIVE		SHUMA e kapitalit bazë ³	SHUMA e interesit	Norma e interesit	Shuma e anuitetit mujor	Gjithsej e paguar	Borxhi i mbetur	Interesi i mbetur	Kohëzgjatja (nga - deri, gjithsej vite)
1	KREDITË AFATSHKURTËR								
	Gjithsej kreditë afatshkurtër	0	0		0	0	0	0	
2	KREDITË AFATGJATE								
	Kredi nga BERZH ³	179.082.430,00	9.175.331,98	3.75	3.042.245,15	27.331.609,83	179.955.964,46	0	0
	Gjithsej kreditë afatgjate (2)	179.082.430,00	9.175.331,98	3.75	3.042.245,15	27.331.609,83	179.955.964,46	0	
4	Gjithsej (1 +3)	179.082.430,00	9.175.331,98	3.75	3.042.245,15	27.331.609,83	179.955.964,46	0	

³ Kapitali bazë është marrë që nga 31.12.2020 mbi detyrimin e fondeve të tërhequra nga kredia dhe nga bilanci, pensionet llogariten çdo tre muaj. Metoda e llogaritjes së pensioneve vjetore, sipas tremujorëve, bëhet në përputhje me tërheqjet e fondeve nga linja e kredisë dhe gjatë vitit 2021 ato do të jenë të ndryshueshme, gjë që do të raportohet në baza tremujore për vitin 2021.